



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 486 / prot.
1

Tiranë më 9.5.2018

VENDIM

Nr. 21, datë 9.5.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 486 Prot., datë 12.03.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën e datës 06.02.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. Cila është përlllogaritja, forma e rimbursimit për çmimin e ujit të pijshëm për pensionistët dhe familjet në nevojë, që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike e bërë nga ana e Bashkisë Tiranë lidhur me përgjegjësinë e saj sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 79, datë 26.07.2017, “Dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm”.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 486 Prot., datë 12.03.2018 pranë Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me anë të komunikimit elektronik i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënien e informacionit brenda datës 19.03.2018.

Me emailin e datës 16.03.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Tiranë i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke sqaruar se, *është në përfundim të procesit të dërgimit të listave të familjeve të përcaktuara si kategori përfituese, për të mundësuar kompensimin e tarifave.*

Në tejkalim të afateve të përcaktuara në Ligjin për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur objektin e kërkesës për informacion.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica", përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Referuar Vendimit Nr. 79, datë 26.07.2017 të Këshillit Bashkiak Tiranë, për "Dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm", ku pika 2 e tij përcakton: *Ngarkohet Bashkia Tiranë të përllogarisë dhe të vlerësoj formën e rimbursimit për çmimin e ujit të pijshëm, për pensionistët dhe familjet që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike*, rezulton se kjo përllogaritje është detyrë e Autoritetit Publik.

Si rrjedhojë, nga ana e Autoritetit Publik duhet të procedohet me dhënien e informacionit të kërkuar.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më lart, në lidhje me ankimin e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSA:

1. Pranimin e ankimit nr. 486 Prot., datë 12.03.2018 të Qendrës “Res Publica”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 06.02.2018, (*Cila është përlogaritja, forma e rimbursimit për çmimin e ujit të pijshëm për pensionistët dhe familjet në nevojë, që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike e bërë nga ana e Bashkisë Tiranë lidhur me përgjegjësinë e saj sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë, nr. 79, datë 26.07.2017, “Dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm”*), brenda datës 12.5.2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 09.5.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

